

VENDIM
Nr. 578, datë 2.12.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
KORÇË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 2.12.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a.’”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a., me shkresën nr. 517 prot., datë 2.11.2022, si dhe me plotësimet me anë të shkresës nr. 533 prot., datë 14.11.2022, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe të rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura” (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. (NUIS M24431001N) është themeluar më datë 12.7.2022, me aksionarë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me 51% dhe bashkitë Korçë me 28.29%, Kolonjë me 3.64%, Devoll me 7.76%, Maliq me 8.67%, Pustec me 0.63%.

b) Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 152 548 banorë të bashkive Korçë, Kolonjë, Devoll, Maliq;

c) Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a. ofron shërbimin trajtimit të ujërave të ndotura për 85 000 banorë të Bashkisë Korçë;

d) Drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Pandi Qirinxhi, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Gjeodezi, në vitin 1985 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

e) Drejtuesi teknik i shoqërisë për impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura, z. Aleks Andoni, është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në degën Kimi industriale, në vitin 1993 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a., të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe të verifikimeve të kërkesës së Shoqërisë Rajonale UK Korçë, rekomandon:

- Shoqëria Rajonale UK Korçë të pajiset me akt miratime higjieno-sanitare për të gjithë zonën e shërbimit, duke përfshirë edhe Bashkinë Pustec.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin, se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. me NUIS: M24431001N, në kategoritë:

- a) kategoria A: “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”;
- b) kategoria C: “Për largimin e ujërave të ndotura”;
- c) kategoria D: “Për trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara. me:

- a) drejtues ligjor: Petrit Tare;
- b) drejtues teknik: Pandi Qirinxhi;
- c) drejtues teknik: Aleks Andoni.

3. Zonat e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. janë bashkitë Korçë, Kolonjë, Devoll, Maliq.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 40, datë 27.1.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a.”, shfuqizohet;

6. Vendimi i KKRR-së nr. 476, datë 9.12.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Devoll sh.a.”, shfuqizohet;

7. Vendimi i KKRR-së nr. 390, datë 21.10.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Maliq sh.a.”, shfuqizohet;

8. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

9. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani